



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
MINISTRIA E FINANCAVE

RAPORTI GJYSMËVJETOR I REALIZIMIT
TË BUXHETIT TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT
JANAR - QERSHOR 2024

Shkup, korrik 2024

PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	2
1. Tendencat ekonomike ndërkombëtare.....	3
2. Tendencat makroekonomike në vend.....	4
2.1. Aktiviteti ekonomik.....	4
2.2. Tregu i fuqisë punëtore.....	7
2.3. Inflacioni dhe lëvizjet monetare.....	7
2.4. Bilanci i pagesave.....	8
3. Sektori fiskal.....	9
3.1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.....	9
3.1.1 Realizimi i buxhetit themelor.....	12
3.1.2 Realizimi i buxhetit të fondeve.....	14
3.1.3 Realizimi i buxhetit të llogarive vetanake për të hyrat e shfrytëzuesve buxhetorë.....	15
3.1.4 Realizimi i Buxhetit të RMV-së sipas shfrytëzuesve buxhetorë.....	15
3.2 Menaxhimi i borxhit publik.....	17

Përmbledhje

- Në tremujorin e parë të vitit 2024, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) shënoi një rritje vjetore prej 1.2% në bazë reale, me ç'rast kërkesa e brendshme kishte kontribut pozitiv në rritjen ekonomike në kushtet e rritjes së investimeve bruto dhe rritjes së konsumit, ndërsa kontributi e eksportit neto në rritje është negative;
- Sipas Anketës së fuqisë punëtore, papunësia ka shënuar rënie në tremujorin e parë të vitit 2024, me ç'rast shkalla e papunësisë arriti në 12.9%, që paraqet rënie prej 0.4 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak;
- Gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, inflacioni vazhdoi me tendencë ngadalësimi të rritjes dhe në muajin qershor 2024 shënoi vlerën prej 3.2% në nivel vjetor. Kumulativisht, në gjashtë muajt e parë, norma mesatare e inflacionit ishte 3.7%;
- Në periudhën janar - qershor 2024, të hyrat e përgjithshme buxhetore janë realizuar në vlerë prej 144.304 milionë denarëve, që paraqet 46.5% të vlerës së planifikuar për vitin 2024 dhe krahasuar me gjysmën e parë të vitit paraprak ato janë rritur për 9.9%;
- Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme buxhetore në periudhën janar - qershor 2024 është 168.162 milionë denarë, që paraqet 48.9% të planit vjetor, me ç'rast në krahasim me gjysmën e parë të vitit paraprak janë rritur për 8.5%;
- Në periudhën janar-qershor 2024, në Buxhetin e RMV-së është realizuar deficit prej 23.858 milionë denarëve, që paraqet 2.64% të PBB-së së projektuar për vitin 2024, si dhe deficit primar që arrin në 1.4% të PBB-së së projektuar për vitin 2024;
- Borxhi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut në fund të tremujorit të parë të vitit 2024 arrin në 51.5% të PBB-së, ndërsa borxhi publik paraqet 59.8% të PBB-së.

1. Tendencat ekonomike ndërkombëtare¹

Aktiviteti ekonomik global tregoi rezistencë në fillim të vitit 2024, i përkrahur nga konsumi i fuqishëm privat në ekonomitë kryesore, me rritje të qëndrueshme, ndërsa inflacioni u ngadalësua në mënyrë graduale. Inflacioni në sektorin e shërbimeve ngadalëson ritmin e inflacionit të përgjithshëm, duke e vonuar dhe komplikuar normalizimin e politikës monetare, por nga ana tjetër, normalizimi i tregjeve të punës dhe rënia e pritshme e çmimeve të energjisë pritet ta stabilizojnë inflacionin. Megjithatë, pavarësisht periudhës së furishme, bota e ka shmangur recesionin, sistemi bankar u tregua kryesisht rezistent dhe ekonomitë e mëdha në zhvillim pësuan goditje të theksuar, megjithëse ritmi i ekspansionit ekonomik mbetet i ulët sipas standardeve historike.


Hartuesit e politikave përballen me dy sfida: stabilizimin e mëtejshëm të çmimeve dhe trajtimin e efekteve të krizave të fundit. Në periudhë afatshkurtrë, kjo do të thotë përzjerje prudenente politikash.

Rritja globale projektohet në 3.2% në vitin 2024, sipas projeksioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të muajit prill 2024, duke e mbajtur ritmin e njëjtë si në vitin 2023. Edhe pse lidhur me projeksionet paraprake të muajit tetor është kryer rishikim në rritje prej 0.3 p.p., rritja e aktivitetit global pritet të jetë ende më e ulët se në periudhën para pandemisë, si rezultat i kostove ende të larta të huamarrjes dhe tërheqjes së përkrahjes fiskale, efekteve afatshkurtra dhe pasojave afatgjata të pandemisë, si dhe invazionit rus të Ukrainës, rritjes së ulët të produktivitetit dhe rritjes së fragmentimit gjeo-ekonomik. (Grafiku 1)

Rritja ekonomike në BE dhe Eurozonë në vitin 2024 projektohet të jetë përkatësisht 1.1% dhe 0.8%, që paraqet rishikim në rënie të normave të rritjes prej 0.4 p.p. krahasuar me raportin e muajit tetor. Gjermania, si partnerja jonë më e rëndësishme tregtare, pritet të arrijë rritje prej 0.2% në vitin 2024, që paraqet rënie prej 0.7 p.p. krahasuar me pritshmëritë paraprake.

Inflacioni global pritet të ulet nga 6.7% në vitin 2023 në 5.9% në vitin 2024, ndërsa në Eurozonë pritet të ulet në 2.4% në 2024 nga 5.4% në vitin 2023. Projeksionet e inflacionit bazohen në pritshmëritë për çmime më të ulëta të produkteve ushqimore bazë në tregjet botërore, çmime më të ulëta të naftës dhe energjisë, si dhe në uljen e inflacionit bazë për shkak të kushteve ende të shtrënguara financiare.

Grafiku 1. Rritja reale e PBB-së (%)



Në përgjithësi, risqet për realizimin e perspektivës së rritjes ekonomike globale janë të balancuara, me përjashtim të disa risqeve afatshkurtra. Risqet afatshkurtra në rritje lidhen me inflacionin dhe janë si rezultat i rritjes së vazhdueshme të çmimeve në sektorin e shërbimeve dhe nga presionet e çmimeve, të cilat, nga ana tjetër, vijnë nga përkeqësimi i marrëdhënieve tregtare apo tensionet gjeopolitike. Eskalimi i tensioneve tregtare mund të rrisë më tej risqet afatshkurtra të inflacionit edhe atë përmes rritjes së çmimeve të mallrave të importuara në zinxhirët e furnizimit. Risku i inflacionit më të lartë rrit mundësinë e normave më të larta të interesit në periudhë afatgjate, duke çuar në rritje të risqeve të jashtme, atyre fiskale dhe financiare. Gjithashtu, rezultojnë risqe nga apreciacioni i zgjatur i dollarit që mund të çrrëgullojë fluksin e kapitalit dhe ta pengojë lehtësimin e

¹ Analiza në këtë pjesë bazohet në raportin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të muajit prill 2024.

planifikuar të politikës monetare, pastaj nga pritshmëritë për ndryshime të rëndësishme në politikën ekonomike si rezultat i zgjedhjeve vjetore në SHBA, si dhe nga tarifat tregtare, të cilat së bashku me politikat stimuluuese industriale në mbarë botën mund të gjenerojnë përhapje të dëmshme ndërkufitare.

Nga ana tjetër, politikat që promovojnë multilateralizmin dhe zbatimin më të shpejtë të reformave makrostrukurore dhe inteligjencës artificiale mund ta nxisin ofertën, produktivitetin dhe rritjen, me përhapje më të gjera pozitive.


2. Tendencat makroekonomike në vend²

2.1. Aktiviteti ekonomik

Në tremujorin e parë të vitit 2024, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) shënoi rritje vjetore prej 1.2% në bazë reale, ku kërkesa e brendshme ka pasur kontribut pozitiv në rritjen ekonomike në kushtet e rritjes së investimeve bruto dhe rritjes së konsumit, ndërsa kontributi i eksportit neto në rritje është negativ.

Konsumi shënoi rritje prej 2.1% në bazë reale, si rezultat i rritjes së konsumit privat dhe atij publik. Konsumi privat u rrit për 2.0%, kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave të disponueshme të amvisërive, në kushtet e rritjes më intensive të pagave në TM1 2024 (rritje reale prej 12.5%), rritjes së pensione dhe kreditimit të amvisërive. Konsumi publik shënoi rritje prej 2.4% në bazë reale. Investimet bruto shënuan rritje dyshifrore prej 23.6% në T1, që paraqet rimëkëmbje të theksuar pas ecuresë negative të vitit 2023, në kushtet e rritjes së importit të të mirave kapitale (rritje nominale prej 34.6%) dhe rritjes së realizimit të shpenzimeve kapitale buxhetore (rritje nominale prej 31.7%).

Grafiku 2. Struktura e shpenzimeve të rritjes ekonomike (kontributi në rritje, pikë përqindje)




Aktiviteti i dobët ekonomik në vendet e BE-së dhe përkatësisht kërkesa e jashtme rezultuan në rënie të eksportit të mallrave dhe shërbimeve prej 7.8% në bazë reale. Rënia e eksportit është kryesisht reflektim i reduktimit të eksportit të substancave dhe produkteve kimike, energjisë elektrike, automjeteve rrugore, mineraleve dhe mbetjeve metalike. Nga ana tjetër, importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi rritje reale prej 0.2%, e nxitur nga importi i produkteve kapitale i cili u rrit për 34.6%, ndërsa rënia e importit të produkteve intermediare u ngadalësua në kushtet e uljes së aktivitetit të eksportit në këtë tremujor. Kështu, eksporti neto ka kontribut negativ në rritjen ekonomike. Kështu, në pesëmujorin e parë të vitit 2024 u regjistrua rënie në shkëmbimin e jashtëm tregtar për 3,3% si rezultat i rënies së eksportit të mallrave për 8.8% me rritje të njëkohshme të importit për 1.0%, që kontribuoi në rritjen e deficitit tregtar për 34.1%.

Sipas analizës së veprimtarive, rritja ekonomike në TM1 2024 i detyrohet ekskluzivisht arritjeve pozitive në sektorin e shërbimeve. Aktiviteti në sektorin e shërbimeve në tërësi ka shënuar rritje prej 4.1% në tremujorin e parë, që vjen kryesisht si rezultat i zhvillimeve të favorshme në veprimtarinë e artit, argëtimit dhe rekreacionit për 19.6%, veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike për 7.5 % dhe në veprimtarinë e tregtisë, transportit dhe

² Në raport shfrytëzohen të dhënat më të fundit të disponueshme. Për PBB-në, të dhënat e papunësisë dhe bilanci të pagesave janë të disponueshme që nga tremujori i parë i vitit 2024.

hotelerisë për 6.9 %. Të dhënat me frekuencë të lartë për tregtinë e brendshme në periudhën janar - maj 2024 tregojnë rritje nominale të qarkullimit për 4.2%, që vjen si rezultat i lëvizjeve të favorshme në të gjitha segmentet e aktivitetit tregtar.

Grafiku 3. Struktura e rritjes ekonomike sipas metodës së prodhimit (kontributi në rritje, p.p.)




Në tre muajt e parë, sektori i ndërtimitarisë shënoi rënie prej 2.5%. Sipas të dhënave mujore për punët e përgjithshme ndërtimore të kryera, ky realizim vjen si pasojë e rënies së aktivitetit ndërtimor në segmentin e ndërtimeve të larta dhe të ndërtimeve të specializuara, ndërsa aktiviteti në segmentin e ndërtimeve të ulëta ka regjistruar rritje. Në këtë periudhë, bujqësia shënoi rënie dyshifrore prej 19.7%, pas rënies prej 15.3% në tremujorin paraprak, me ç'rast vijojnë arrijet negative në këtë sektor.

Në tremujorin e parë, aktiviteti në sektorin industrial shënoi rënie prej 1.2%, në suaza të të cilit industria e përpunimit shënoi rënie prej 0.3%. Sipas të dhënave me frekuencë të lartë, rënie në tremujorin e parë të vitit 2024 shënoi edhe sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar prej 24.5% dhe sektori i minierave dhe nxjerrjes së gurëve prej 2.3%.

Sipas të dhënave zyrtare, prodhimi industrial ka rënë edhe në muajin maj të vitit 2024, me rënie vjetore prej 13.2%, që është rezultat i prodhimit më të ulët në të gjithë sektorët, përkatësisht: minierat dhe nxjerrja e gurëve për 17.1%, industria e përpunimit për 10.6% dhe sektori i energjetikës për 18.4%. Rënia e prodhimit industrial, e cila në pesë muajt e parë të vitit arriti në 4.9% ishte kryesisht si rezultat i uljes së prodhimit në degët tradicionale industriale si prodhimet e duhanit, lëkurës, veshmbathjeve dhe përpunimi i drurit dhe prodhimet kompjuterike, si dhe produktet elektronike dhe optike. Në periudhën janar - maj 2024, prodhimi i energjisë elektrike shënoi rënie prej 26.7% si rezultat i bazës së lartë krahasuese të vitit paraprak kur u arrit rritje kumulative prej 13.0%, e cila erdhi si pasojë e masave përkrahëse për shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve vendase për prodhimin e energjisë elektrike.

Grafiku 4. Rritja vjetore e prodhimit industrial (në %)



Ekonomia ishte më e dobët në vitin 2023 krahasuar me pritshmëritë, të dhënat për lëvizjen ekonomike në gjysmën e parë të 2024 dhe mjedisi më pak i favorshëm ndërkombëtar kushtëzojnë rishikim në rënie të pritshmërive për rritjen e ekonomisë vendase këtë vit, që projektohet në nivel prej 2.1% kundrejt rritjes paraprake prej 3.4% sipas projeksioneve për muajin dhjetor të vitit 2023. Rritja pritet të nxitet nga kërkesa e brendshme, ndërsa eksporti neto pritet të ketë kontribut negativ ndaj rritjes.

Pritet që konsumi privat të vazhdojë të jetë një nga nxitësit kryesorë të rritjes, i përkrahur nga rritja e të ardhurave të disponueshme dhe aktivitetit solid kreditor të sistemit bankar. Të ardhurat e disponueshme përkrahen nga rritja e lartë e pagave në bazë reale, si dhe nga rritja lineare e pensioneve që do ta dinamizojë konsumin në periudhën e ardhshme. Kështu, konsumi privat pritet të shënojë rritje prej 2.7% në bazë reale

Parashikimet e investimeve bruto janë që ato të rriten prej 10.0%, që vjen kryesisht si pasojë e bazës së ulët krahasuese, respektivisht rënies prej 16.7% në vitin 2023, si dhe se të nxitin nga rritja e investimeve në mjetet fikse, respektivisht makineritë dhe pajisjet dhe nga normalizimi i nivelit të stoqeve gjatë vitit. Kontribut adekuat pritet edhe nga realizimi më efikas i projekteve infrastrukturore të filluara në pjesën e mbetur të vitit, si dhe nga realizimi i projekteve që kanë të bëjnë me infrastrukturën lokale.

Pritshmëritë për konsumin publik janë që ai të shënojë rritje prej 3.3% në kushtet e rritjes së shpenzimeve për paga si pasojë e nevojës për harmonizimin e marrëveshjeve kolektive të nënshkruara paraprake, shoqëruar me ulje të shpenzimeve joproduktive për mallra dhe shërbime.

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve pritet të rimëkëmbet në periudhën e ardhshme (pas rënies në vitin 2023) si rezultat i perspektivave disi më të favorshme të rritjes të partnerët kryesorë tregtarë. Aktiviteti i eksportit pritet të përkrahet nga efektet e favorshme të çmimeve të metaleve në sektorin tradicional të eksportit, performancat adekuate të vazhdueshme të kompanive nga industria e automobilave, si dhe investimet e mëtejshme për rritjen e kapaciteteve në zonat e lira industriale. Si rrjedhojë e kësaj, eksporti pritet të ketë rritje prej 2.5%.

Rritja e eksportit, por edhe rritja e kërkesës së brendshme dhe investimeve, pritet të ndikojnë në rritjen e importit të mallrave dhe shërbimeve, respektivisht me dinamikë më të fuqishme (pjesërisht për shkak të rënies më të madhe prej 5.8% në vitin 2023). Pritshmëritë janë që ai të shënojë rritje prej 5.4%, ndërsa kontributi i përgjithshëm i eksportit neto të jetë negativ.

Norma e inflacionit për vitin 2024 është projektuar në 3.5%, që paraqet ngadalësim të theksuar të dinamikës së çmimeve krahasuar me vitin 2023. Gjatë gjysmës së dytë të vitit, pritet ngadalësim i mëtejshëm i rritjes së inflacionit, përkatësisht stabilizim i çmimeve të ushqimeve dhe energjensave, si dhe presion më i moderuar nga inflacioni bazë.

Zhvillimet pozitive të tregut të punës pritet të vazhdojnë edhe në periudhën e ardhshme, por me dinamikë disi më të moderuar krahasuar me projeksionet e mëparshme. Pritet edhe rritje e numrit të të punësuarve për rreth 1%, si dhe ulje të shkallës së papunësisë për vitin 2024 në nivel prej 12.6%. Lidhur me pagën mesatare neto, rritja e lartë do të ruhet gjatë vitit 2024 dhe projektohet që ajo të jetë në nivelin mesatar prej 13%, në kushtet e rritjes së pagave në veprimtari të caktuara të sektorit publik dhe rritjes së pagave në disa veprimtari shumë produktive.

Skenari bazë makroekonomik shoqërohet me risqe, të cilat vlerësohen në rënie në raport me rritjen e projektuar ekonomike. Risqet për mjedisin e jashtëm vazhdojnë të lidhen me tensionet gjeopolitike, përkatësisht me luftën në Ukrainë dhe konfliktin në Lindjen e Mesme. Thellimi i mëtejshëm i fragmentimit gjeo-ekonomik duke imponuar kufizime shtesë në fluksin e mallrave, kapitalit dhe njerëzve do të kishte efekte negative në zinxhirët e furnizimit dhe çmimet e bursës, ndërsa në mënyrë përkatëse edhe në tregtinë dhe mjedisin e jashtëm. Risqet për projeksionin e inflacionit lidhen me lëvizjet e çmimeve të produkteve themelore, përkatësisht rritja e tyre është për shkak të faktorëve gjeopolitikë dhe çrregullimit të zinxhirit të furnizimit, si dhe risqet e brendshme që lidhen me tregun e punës dhe rregullimin e çmimeve. Në lidhje me mjedisin e brendshëm, risku kryesor është vonesa e mëtejshme në zbatimin e projekteve të planifikuara infrastrukturore.

Tabela 1. Krahasimi i projeksioneve për rritjen ekonomike dhe inflacionin për vitin 2024 (në%)

	Rritja ekonomike	Inflacioni
Ministria e Financave	2,1%	3,5%
FMN-ja	2,7	4,0
Banka Botërore	2,5	3,0
Komisioni Evropian	2,9	3,0
BERZH-i	2,5	/
Agjencia e Rejtingut Kreditor "FITCH"	2,9	3,7
Banka Popullore e RMV-së	2,6	3,5

Burimi: Projektionet e Ministrisë së Financave, FMN-ja (IMF Staff Concludes Visit to North Macedonia, prill 2024), Banka Botërore (Western Balkans Regular Economic Report, prill 2024), Komisioni Evropian (European Economic Forecast, maj 2024), BERZH-i (Regional Economic Prospects, maj 2024), Agjencia Kreditore "Fitch" (Fitch Ratings, prill 2024) dhe Banka Popullore e RMV-së (Raporti tremujor, maj 2024).


2.2. Tregu i fuqisë punëtore

Sipas Anketës së fuqisë punëtore, papunësia ka shënuar rënie në tremujorin e parë të vitit 2024, me ç'rast shkalla e papunësisë ka arritur në 12.9%, që paraqet rënie prej 0.4 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak.

Shkalla e punësimit në tremujorin e parë të vitit 2024 është 45.4% dhe krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2023 është rritur me 0.3 p.p., ndërkohë që popullsia aktive përbëhet prej 52.1% të popullsisë së përgjithshme të punës dhe është rritur për 0.1 p.p. krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2023.

Në pesë muajt e parë të vitit 2024, pagat shënuan rritje mesatare prej 13.1% në bazë nominale (Grafiku 5). Gjatë kësaj periudhe, rritje e pagave mesatare vihet re në të gjithë sektorët, me ç'rast më e theksuar është në arsim, art, argëtim dhe rekreacion, administratë publike dhe mbrojtje, furnizim me ujë, bujqësi, furnizim me energji elektrike dhe industri të përpunimit.

Grafiku 5. Rritja e pagës mesatare neto (në %)




2.3. Inflacioni dhe lëvizjet monetare

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2024, inflacioni vazhdoi me tendencë ngadalësimi edhe në muajin qershor të vitit 2024 dhe shënoi 3.2% në nivel vjetor. Kumulativisht, në gjashtë muajt e parë, norma mesatare e inflacionit ishte 3.7%.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2024, inflacioni rrjedh kryesisht nga komponenti bazë, i cili shënon rënie më të ngadaltë të çmimeve, respektivisht në gjysmën e parë të vitit, inflacioni bazë arrin në 4.9%. Në fund të tremujorit të parë, çmimet e ushqimeve u përshpejtuan, që vjen si pasojë e rritjes së çmimeve të perimeve dhe frutave, si dhe heqjes së

masave për uljen e çmimeve të ushqimeve në shitjen me pakicë. Lëvizje të tilla vazhduan deri në maj 2024, pasi në muajin qershor çmimet e ushqimeve shënuan ngadalësim të rritjes në nivel vjetor. Kumulativisht, në gjashtëmuajorin e parë, çmimet e ushqimeve shënuan rritje prej 3.0% dhe ulje të kontributit në inflacionin e përgjithshëm. Në periudhën janar - qershor 2024, çmimet e energjisë dhe derivateve të naftës shënuan rritje përkatësisht prej 2.7% dhe 0.7%, që është në përputhje me lëvizjet e bursave botërore.

Grafiku 6. Inflacioni i përgjithshëm dhe bazik (në%)



Në përputhje me nevojën për stabilizimin e inflacionit dhe pritshmëritë inflacioniste në baza më të qëndrueshme, Banka Popullore gjatë muajit qershor të vitit 2024 e ruajti normën bazë të interesit në nivel prej 6.3%, e cila ka mbetur e pandryshuar që nga muaji shtator i vitit 2023.


Aktiviteti kreditor në muajin qershor të vitit 2024 u rrit për 6.4% në bazë vjetore, në kushtet e rritjes së kredive për ndërmarrjet dhe kredive për amvisëritë, respektivisht për 5.8% dhe 7.1%. Kredia në valutën vendase është rritur për 11.7%, ndërsa kredia në valutën e huaj është ulur për 0.4%.

Potenciali i përgjithshëm i depozitave në muajin qershor 2024 shënoi rritje prej 7.2% me bazë vjetore për sa i përket rritjes së depozitave të kompanive dhe depozitave të amvisërive, përkatësisht për 4.7% dhe 8.9%. Analizuar sipas aspektit valutor, depozitat në valutën vendase dhe atë të huaj shënuan rritje vjetore, përkatësisht për 9.9% dhe 3.9%.

2.4. Bilanci i pagesave

Llogaria rrjedhëse e bilancit të pagesave shënoi deficit prej 185.0 milionë eurove në tremujorin e parë të vitit 2024, kundrejt suficitit prej 92.8 milionë eurove në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, që ishte kryesisht si pasojë e rritjes së deficitit në llogarinë e mallrave (35.1%) dhe në llogarinë e të adhurave primare (4.4%), si dhe uljes së suficitit në llogarinë e të ardhurave sekondare për 17.2%. Efekt pozitiv kishte rritja e suficitit në llogarinë e shërbimeve për 19.2%. Fluksi hyrës i Investimeve të Huaja Direkte (IHD) është 290.2 milionë euro dhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është rritur për 134.1 milionë euro, që kryesisht vjen si rezultat i rritjes së fluksit hyrës në bazë të kapitalit vetanak dhe instrumenteve të borxhit.

Grafiku 7. Saldoja e llogarisë rrjedhëse dhe fluksi i të hyrave të IHD-ve (në milionë euro)




Vlera e rezervave devizore në muajin qershor 2024 arrin në 4.3 miliardë euro dhe sigurojnë mbulimin e importit të mallrave dhe shërbimeve prej 4.4 muajsh të periudhës paraprake 12 mujore, që paraqet nivel të duhur të rezervave.

3. Sektori fiskal

3.1. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024, të hyrat e përgjithshme janë planifikuar në vlerë prej 310.097 milionë denarë, shpenzimet e përgjithshme në vlerë prej 343.638 milionë denarë, respektivisht është planifikuar deficit prej 33.541 milionë denarë (deficiti i buxhetit themelor prej 28.318 milionë denarë, deficiti i fondeve prej 2.004 milionë denarë dhe deficiti i llogarive për të hyrat vetanake prej 3.219 milionë denarë).

Grafiku 8. Paraqitja skematike e Buxhetit të RMV-së, realizimi (në milionë denarë) dhe shkalla e realizimit (në %) në gjysmëvjetorin e parë të vitit 2024



Të hyrat e përgjithshme buxhetore janë realizuar në vlerë prej 144.304 milionë denarë, që paraqet 46.5% të vlerës së planifikuar për vitin 2024, respektivisht rritje prej 9.9% në raport me të hyrat buxhetore të realizuara në periudhën e njëjtë të vitit 2023 (Tabela 2). Në kuadër të të hyrave të përgjithshme, në bazë të të hyrave tatimore dhe kontributeve sociale janë realizuar 133.952 milionë denarë, me të cilat shkalla e realizimit ishte 48% nga vlera e planifikuar për vitin 2024, respektivisht u shënuar rritje prej 14.4% krahasuar me vitin paraprak. Njëkohësisht, janë realizuar të hyra tatimore në vlerë të

përgjithshme prej 82.895 milionë denarë³ (përkatësisht realizim prej 47% nga vlera e planifikuar për vitin 2024), ndërsa kontributet janë realizuar në vlerë prej 50.195 milionë denarë (ritje vjetore prej 14.4%, përkatësisht 49.7% e vlerës së planifikuar për vitin 2024). Në kuadër të të hyrave tatimore, ritje vërehet te të gjitha të hyrat, përkatësisht: të hyrat tjera tatimore për 54.1%, tatimi mbi fitimin për 23.1%, tatimi mbi të ardhurat personale për 17.8%, duke vazhduar me detyrimet e importit me ritje të arkëtimit për 14.7%, tatimi i vlerës së shtuar me ritje prej 13.5% dhe akciza për 3.8%.

Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme të Buxhetit të RMV-së në periudhën janar - qershor 2024 ishte 168.162 milionë denarë, që paraqet 49.0% të planit vjetor, respektivisht ritje prej 8.5% krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2023. Njëkohësisht, shpenzimet rrjedhëse u realizuan në vlerë prej 155.232 milionë denarë, gjegjësisht 52.0% nga vlera e planifikuar për tërë vitin, që paraqet ritje prej 16.8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Ritje vërehet edhe te shpenzimet e interesit për 67.8%, te shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve për 8.6% dhe te pagat dhe kompensimet për 22.7%. Transfertat, të cilat janë kategoria më e madhe e shpenzimeve rrjedhëse, u rritën për 13.2% duke ndjekur rritjen e lartë të transfertave sociale prej 15.9%, shpenzimet e mbrojtjes shëndetësore prej 14.2%, dotacionet bllok dhe të dedikuara prej 11.7%, si dhe subvencionet dhe transfertat prej 3.8%. Shpenzimet kapitale u realizuan në vlerë prej 12.930 milionë denarëve dhe janë më të ulta për 41.0% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Shkalla e realizimit të shpenzimeve kapitale në gjysmën e parë të vitit në raport me buxhetin fillestar ishte 28.6%.

³ Të përfshira janë edhe të hyrat e llogarive vetanake në vlerë prej 862 milionë denarëve.

Tabela 2. Realizimi i Buxhetit të RMV-së për periudhën janar - qershor të vitit 2024

	Buxheti 2024	Janar - qershor 2024		
	milionë denarë	milionë denarë	shkalla vjetore e rritjes (në %)	shkalla e realizimit
TË HYRA TË PËRGJITHSHME	310,097	144,304	9.9%	46.5%
Tatime dhe kontribute	279,044	133,952	14.4%	48.0%
Tatime	178,067	82,895	14.2%	47.0%
Tatimi mbi të ardhurat personale	31,116	14,733	17.8%	47.3%
Tatimi mbi fitimin	19,483	11,960	23.1%	61.4%
TVSH	80,698	36,147	13.5%	44.8%
Akcizat	30,969	13,447	3.8%	43.4%
Detyrime të importit	12,124	6,084	14.7%	50.2%
Të hyra të tjera tatimore	3,677	1,299	54.1%	47.5%
Kontribute	100,977	50,195	14.4%	49.7%
Të hyra jotatimore	20,394	8,810	13.2%	43.2%
Të hyra kapitale	3,210	346	-9.7%	10.8%
Donacione nga jashtë	7,449	1,196	-79.9%	16.1%
Të hyra nga huatë e arkëtuara	0	0	/	/
SHPENZIME TË PËRGJITHSHME	343,638	168,162	8.5%	48.9%
Shpenzime rrjedhëse	298,459	155,232	16.8%	52.0%
Paga dhe kompensime	41,178	21,065	22.7%	51.2%
Mallra dhe shërbime	25,113	10,306	8.6%	41.0%
Transferta	215,358	112,639	13.2%	52.3%
Transferta sociale	161,842	82,611	15.9%	51.0%
FSPIMV	98,995	52,066	18.1%	52.6%
Kompensim financiar për të papunësuarit	3,026	836	11.3%	27.6%
Ndihma sociale	14,089	7,448	5.7%	52.9%
Mbrojtja shëndetësore	45,732	22,261	14.2%	48.7%
Transferta të tjera	53,516	30,028	7.5%	56.1%
Interesi	16,810	11,052	67.8%	66.8%
Shpenzime kapitale	45,179	12,930	-41.0%	28.6%
SALDOJA E BUXHETIT	-33,541	-23,858	0.8%	71.1%

Burimi: Ministria e Financave

Në periudhën janar - qershor 2024, deficit i Buxhetit të RMV-së është realizuar prej 23.858 milionë denarëve, që paraqet 2.64% të PBB-së së projektuar për vitin 2024, përkatësisht 71.13% e planit vjetor (Tabela 2).

Në kuadër të Buxhetit të RMV-së, buxheti themelor realizoi deficit prej 28.318 milionë denarëve, mjetet suficite prej 4.900 milionë denarëve, ndërsa në llogaritë për të hyrat vetanake është realizuar deficit në vlerë prej 441 milionë denarëve.


3.1.1 Realizimi i buxhetit themelor

Të hyrat e përgjithshme të buxhetit themelor në periudhën janar – qershor 2024 ishin 85.819 milionë denarë. Ato paraqesin 46.0% e të hyrave të përgjithshme të parashikuara për vitin 2024 në vlerë prej 186.742 milionë denarëve.

Arkëtimi i të hyrave tatimore në këtë periudhë, që paraqet zërin më të rëndësishëm në kuadër të të hyrave të përgjithshme, shënon 82.060 milionë denarë, përkatësisht 47.2% të planit vjetor, ndërsa të hyrat jotatimore dhe kapitale janë realizuar në vlerë prej 3.759 milionë denarëve ose 32.8% krahasuar me ato që janë planifikuar për të gjithë vitin.

Struktura e të hyrave tatimore të realizuara tregon se tatimi mbi vlerën e shtuar ka pjesëmarrjen më të madhe me 36.147 milionë denarë ose 44.8% e të hyrave tatimore të përgjithshme (Grafiku 9). Pastaj vijnë të hyrat mbi bazën e tatimit të të ardhurave personale me 14.733 milionë denarë, akcizat me 12.699 milionë denarë, tatimi mbi fitimin me 11.960 milionë denarë, tatimi mbi detyrimet e importit me 6.084 milionë denarë dhe të hyrat e tjera tatimore me 437 milionë denarë.


Grafiku 9. Struktura e të hyrave tatimore, janar – qershor 2024



Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit themelor në periudhën janar - qershor 2024 janë realizuar në vlerë prej 114.052 milionë denarëve ose 53.0% e mjeteve të përgjithshme të parapara me buxhetin themelor për vitin 2024.


Në strukturën e shpenzimeve të kryera në këtë periudhë, pjesëmarrjen më të madhe e zënë transfertat rrjedhëse të mjeteve buxhetore me 25.634 milionë denarë. Pastaj ndjekin pagat dhe kompensimet me 19.959 milionë denarë, subvencionet dhe transfertat me 18.380, transfertat rrjedhëse të njësitë e vetëqeverisjes lokale me 14.726 milionë denarë, pagesat e interesit 11.052 milionë denarë, shpenzimet kapitale me 9.693 milionë denarë, benefitet sociale me 7.358 dhe shpenzimet për mallrat dhe shpenzimet me 7.250 milionë denarë. Grafiku 10 tregon përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në shpenzimet e përgjithshme.

Grafiku 10. Struktura e shpenzimeve të realizuara sipas klasifikimit ekonomik, janar – qershor 2024



Shkalla e realizimit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 43.0%. Në Grafikon 11 janë paraqitur të dhëna të dezagreguara për shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve.

Grafiku 11. Shpenzimet për mallrat dhe shërbimet, janar – qershor 2024 (në milionë denarë).



Në gjysmën e parë të vitit, transfertat rrjedhëse te mjetet buxhetore përqasin 8.7% të planit vjetor. Në kuadër të kësaj kategorie, 56.9% bëjnë pjesë transferatat në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë së Veriut (Fondi i SPIMV-së), ndërsa pjesa tjetër janë transfertat në Fondin e Sigurimit Shëndetësor dhe Agjencinë e Punësimit.


Nga mjetet e përgjithshme të planifikuara për transfertat rrjedhëse te NJVL-të për vitin 2024, në gjysmën e parë të vitit janë realizuar 49.4%. Në kuadër të kësaj kategorie, vlera më e madhe ose 86.5% janë realizuar mbi bazën e dotacioneve bllok dhe atyre destinuar, ndërsa pjesa tjetër është mbi bazën e dotacioneve të TVSH-së.

Shkalla e realizimit në kategorinë e subvencioneve dhe transfertave në periudhën e shqyrtuar është 61.9%. Pjesa më e madhe e këtyre mjeteve, respektivisht 5.002 milionë denarë janë paguar mbi bazën e subvencioneve bujqësore nga ana e Agjencisë së Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Benefitet sociale në periudhën janar – qershor paraqesin 54.0% të planit vjetor.

Në periudhën e shqyrtuar, shpenzimet kapitale paraqesin 29.1% të mjeteve të planifikuara për këtë qëllim me buxhetin themelor për vitin 2024, Në Grafikon 12 janë paraqitur të dhëna të dezagreguara për shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve.

Grafiku 12. Shpenzimet kapitale, janar – qershor 2024 (në milionë denarë)



Në periudhën e shqyrtuar, nga buxheti themelor është kryer pagesa e principalit (kryegjësë) në raport me borxhin e përgjithshëm në vlerë prej 23.370 milionë denarëve, ndërsa pagesat mbi bazën e interesit janë 11.052 milionë denarë. Nga flukset dalëse të përgjithshme mbi bazën shlyerjes së kredive, 13.473 milionë denarë janë për pagesën principalit kundrejt kreditorëve vendorë, ndërsa 9.897 milionë denarë janë flukse dalëse për pagesën e principalit kundrejt kreditorëve jorezidentë. Për shpenzimet mbi bazën e interesit kundrejt kreditorëve vendorë janë paguar 3.160 milionë denarë, ndërsa kundrejt kreditorëve të huaj janë paguar 7.892 milionë denarë.

3.1.2 Realizimi i buxhetit të fondeve

Në gjysmën e parë të vitit, Fondi i SPIMV-së ka realizuar suficit prej 3.538 milionë denarëve. Deri në muajin qershor, realizimi i të hyrave dhe fluksit hyrës ishte 60.447 milionë denarë, që paraqet 55.6% krahasuar me ato që u planifikuarn për vitin 2024, ndërsa realizimi i shpenzimeve është 56.910 milionë denarë, përkatësisht 51.5% e planit vjetor. Nga të hyrat e përgjithshme, 32.793 milionë denarë janë të hyra mbi bazën e kontributeve për sigurimin e Fondit Pensional dhe Invalidor (48.4% e planit vjetor), 25.634 milionë denarë janë transfertat nga buxheti themelor, 748 milionë denarë janë të hyra nga akcizat, 682 milionë denarë janë të hyra nga vetëpunësimi, 343 milionë denarë janë të hyra nga të ardhurat personale, 94 milionë denarë janë të hyra nga bujqit individualë, ndërsa pjesa tjetër prej 153 milionë denarëve janë të hyra të tjera të Fondit.

Në pjesën e shpenzimeve të Fondit të SPIMV-së, kostot për pensionet janë realizuar në vlerë prej 44.188 milionë denarëve ose 51.6% nga ato që janë paraparë për vitin 2024. Pagesa e pensioneve kryhet në përputhje me dinamikën e paraparë për vitin 2024. Transfertat nga Fondi i SPIMV-së te fondet pensionale private janë 7.878 milionë denarë, ndërsa transfertat e kontributeve për sigurimin shëndetësor të pensionistëve nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor janë 4.508 milionë denarë. Shpenzimet për pagat, mallrat dhe shërbimet, si dhe shpenzimet e tjera janë në vlerë prej 336 milionë denarëve.

Deri në muajin qershor 2024, Fondi i Sigurimit Shëndetësor ka realizuar suficit në vlerë prej 440 milionë denarëve, sa i përket të hyrave të realizuara janë në vlerë prej 22.988 milionë denarëve, që paraqet 49.6 të planit vjetor dhe shpenzimet e realizuara janë në vlerë prej 22.548 milionë denarëve, përkatësisht 48.6% nga ato që janë planifikuar për vitin 2024.

Në periudhën e shqyrtuar janë realizuar të hyra nga kontributet e sigurimit shëndetësor në vlerë prej 14.203 milionë denarëve ose 52% e planit vjetor. Kontributet për sigurimin shëndetësor të pensionistëve të paguara nga Fondi i SPIMV-së janë 4.508 milionë denarë, ndërsa kontributet për sigurimin shëndetësor të paguara nga Agjencia e Punësimit e RMV-së janë 61 milionë denarë. Transfertat nga buxheti themelor janë 3.915 milionë denarë, të hyrat nga participimi 251 milionë denarë, ndërsa të hyrat e tjera janë 50 milionë denarë. Në pjesën e shpenzimeve, janë realizuar kosto për mbrojtjen shëndetësore primare në vlerë prej 18.995 milionë denarëve, shpenzimet për pushimet mjekësore janë 2.592 milionë denarë, për ndihmën ortopedike 393 milionë denarë dhe për trajtimet shëndetësore jashtë shtetit 281 milionë denarë. Shpenzimet për pagat, mallrat dhe shërbimet, si dhe shpenzimet kapitale janë 287 milionë denarë.

Në periudhën janar - qershor 2024, Agjencia e Punësimit e RMV-së ka realizuar suficit në vlerë prej 922 milionë denarëve, sa i përket të hyrave të realizuara në vlerë prej 2.088 milionë denarëve (56.8% nga ato që janë planifikuar për vitin 2024) dhe janë kryer shpenzime në vlerë prej 1.166 milionë denarëve (29.8% krahasuar me buxhetin vjetor). Kontributet mbi bazën e sigurimeve në rast papunësie janë zëri kryesor i të hyrave dhe ato janë realizuar në vlerë prej 2.080 milionë denarëve, përkatësisht 58% e planit vjetor.

Shpenzimet e Agjencisë së Punësimit në gjysmën e parë të vitit: mbi bazë të kompensimit financiar për personat e papunësuar - 613 milionë denarë, mbi bazë të mjeteve për punësimin e personave inavlidë – 88 milionë denarë, për masat aktive të punësimit – 223 milionë denarë dhe për pagesën e kompensimeve për sigurimin individual dhe shëndetësor për personat e papunësuar – 61 milionë denarë. Shpenzimet e Agjencisë, sa i përket pagave, mallrave dhe shërbimeve janë në vlerë prej 181 milionë denarëve.

3.1.3 Realizimi i buxhetit të llogarive vetanake për të hyrat e shfrytëzuesve buxhetorë

Në përputhje me Buxhetin e RMV-së për vitin 2024 është planifikuar deficit në buxhetet e llogarive vetanake për të hyrat e shfrytëzuesve buxhetorë (të destinuara për aktivitetet e vetëfinancuara, huatë dhe donacionet) në vlerë prej 3.219 milionë denarëve, ndërsa deficitin i realizuar në periudhën e analizuar është në vlerë prej 441 milionë denarëve.

Deri në muajin qershor 2024, të hyrat e përgjithshme të realizuara në këto llogari ishin 6.993 milionë denarë (35.1% e planit për vitin 2024), ndërsa janë realizuar shpenzime prej 7.434 milionë denarëve (31.1% e buxhetit vjetor). Në kuadër të shpenzimeve, për shpenzimet rrjedhëse janë harxhuar 4.275 milionë denarë ose 37.3% e planit vjetor, kurse për shpenzimet kapitale 3.159 milionë denarë ose 27% e planit vjetor.

3.1.4 Realizimi i Buxhetit të RMV-së sipas shfrytëzuesve buxhetorë⁴

Në vijim është dhënë pasqyra e shpenzimeve dhe fluksit dalës nga Buxheti i RMV-së për shfrytëzuesit më të mëdhenj buxhetorë, ku buxheti i përgjithshëm vjetor është 87.7% e buxhetit të përgjithshëm të të gjithë shfrytëzuesve buxhetorë (Grafiku 13).

Në gjysmën e parë të vitit 2024, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka realizuar 38.340 milionë denarë ose 65.3% nga buxheti i planifikuar për vitin 2024. Pjesa më e madhe (72.6%) e mjeteve të shpenzuara në këtë periudhë janë destinuar për transfertat rrjedhëse te fondet jashtëbuxhetore, ku janë shpenzuar 27.746 milionë denarë ose 70.8% e mjeteve të destinuara për vitin 2024. Zëri i dytë më i rëndësishëm i shpenzimeve janë benefitet sociale, që paraqesin 19.3% e shpenzimeve të përgjithshme dhe për këtë qëllim janë realizuar 54.1% (7.357 milionë denarë) nga ato që janë planifikuar për vitin 2024.

Në periudhën janar – qershor 2024, përmes ndarjes Ministria e Financave – funksionet e shtetit⁵ janë realizuar 39.913 milionë denarë, përkatësisht 54.7 % nga mjetet e parapara për vitin 2024. Pagesa e principalit


⁴ Të dhënat e detajuara për të hyrat dhe shpenzimet mbi shfrytëzuesit buxhetorë janë dhënë në tabelat në linkun e mëposhtëm: <https://finance.gov.mk/izvestiai-trezor/>.

Të dhënat janë preleminare dhe të pakonsoliduara, respektivisht përfshijnë fluksin hyrës dhe dalës të mjeteve.

⁵ Në kuadër të kësaj ndarjeje janë përfshirë aktivitetet si: servisimi në kohë i detyrimeve të shtetit mbi bazën e huamarrjeve vendore dhe

(23.475 milionë denarë) është zëri më i rëndësishëm i shpenzimeve të përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor me pjesëmarrje prej 59.4%, ndërsa mjetet e planifikuara për vitin 2024 janë realizuar 52.2%. Realizimi i interesit është 66.8% e vlerës së gjithë vitit, përkatësisht 11.224 milionë denarë, ndërsa në shpenzimet e përgjithshme ky zë ka pjesëmarrje me 28.4%. Zëri i tretë më i rëndësishëm, me pjesëmarrje prej 9.1%, janë shpenzimet kapitale, për të cilat janë shpenzuar 2.130 milionë denarë.

Grafiku 13. Struktura e shpenzimeve dhe fluksit dalës sipas shfrytëzuesve buxhetorë, janar-qershor 2024.



Në periudhën janar-qershor 2024, Ministria e Arsimit dhe Shkencës realizoi mjete buxhetore në vlerë prej 19.215 milionë denarëve (51.1% nga planifikimi), të cilat janë për 19.1% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Pjesën më të madhe të shpenzimeve (61.4%) e zënë transfertat rrjedhëse të NJVL-të, për të cilat janë shpenzuar 10.752 milionë denarë ose 50.2% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara. Pagat dhe kompensimet është zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 18.9% dhe në këtë drejtim janë shpenzuar 3.303 milionë denarë, përkatësisht 58.1% nga ato që janë planifikuar.

Në gjysmën e parë të vitit 2024, Ministria e Punëve të Brendshme realizoi gjithsej 6.997 milionë denarë, që paraqet 53.63% të Buxhetit për vitin 2024 dhe që është për 14.3% më shumë krahasuar me vitin paraprak. Zëri më i rëndësishëm i shpenzimeve është ai i pagave dhe kompensimeve me pjesëmarrje prej 75.1%, prej të cilave janë shpenzuar 4.798 milionë denarë ose 52.3% nga planifikimi. Zëri i dytë më i rëndësishëm është ai i mallrave dhe shërbimeve me pjesëmarrje prej 13.5% dhe për këtë zë janë realizuar 855 milionë denarë, që paraqet 64.3% e planit vjetor.

Në periudhën janar - qershor të vitit 2024, Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural (APFBZHR) realizoi mjete në vlerë prej 5.382 milionë denarëve (64.1% nga mjetet e planifikuara të përgjithshme për vitin 2024). Zëri kryesor për këtë shfrytëzues buxhetor me pjesëmarrje prej 93% të shpenzimeve të përgjithshme është zëri i subvencioneve dhe transfertave, ku janë realizuar në vlerë prej 5.002 milionë denarëve, përkatësisht 72.3% nga planifikimi.

Në gjysmën e parë të vitit 2024, Ministria e Mbrojtjes realizoi mjete buxhetore në vlerë prej 9.426 milionë denarëve, që është 46.8% nga buxheti i përgjithshëm për këtë vit. Ato janë më të larta për 47.2% krahasuar me vitin paraprak. Pjesëmarrjen më të madhe të shpenzimeve të kanë pagat dhe kompensimet me 30.8%, për të cilat realizimi në periudhën janar - qershor të vitit 2024 është 2.887 milionë denarë (49.4% nga mjetet e përgjithshme të planifikuara). Shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë pjesëmarrje prej 16.5% të shpenzimeve të përgjithshme. Për këtë qëllim janë shpenzuar 1.547 milionë denarë, përkatësisht 41.8% nga ato që janë parashikuar.

të huaja; pagesa e rregullt e kostove operative të shtetit sipas dokumentacionit paraprak të pagesës së dorëzuar: pjesëmarrja në kapitalin e institucioneve financiare ndërkombëtare; pagesa e TVSH-së mbi bazën e investimeve kapitale financiare nga donacionet, financimin e projekteve nga komponentët individualë të IPA-së etj.

Në gjashtë muajt e parë të vitit 2024, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka realizuar mjete në vlerë prej 2.036 milionë denarëve, që është 39.3% nga planifikimi për vitin dhe janë më të ulëta për 10.6% krahasuar me vitin paraprak. Zëri buxhetor me pjesëmarrje më të madhe të shpenzimet e përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor janë shpenzimet kapitale me pjesëmarrje prej 58,5% janë subvencionet dhe transfertat, për të cilat janë realizuar 1.190 milionë denarë ose 37.3% nga mjetet e planifikuara për vitin 2024. Zëri i dytë i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 10% janë shpenzimet kapitale, ku janë shpenzuar 203 milionë denarë, përkatësisht 34.1% nga planifikimi për vitin 2024.


Ministria e Shëndetësisë në gjysmën e parë të vitit realizoi mjete buxhetore në vlerë prej 3.059 milionë denarëve (ritje prej 24.8% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak), që është 39.9% nga buxheti i përgjithshëm për vitin 2024. Shpenzimet për transfertat rrjedhëse të fondet jashtëbuxhetore e kanë pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet e përgjithshme me 63,5%, për të cilat në periudhën janar – qershor të vitit 2024 janë shpenzuar 1.547 milionë denarë ose 44.2% nga mjetet e destinuara për vitin 2024. Mallrat dhe shërbimet janë zëri i dytë më i rëndësishëm me pjesëmarrje prej 27.2% në shpenzimet e përgjithshme dhe në periudhën e analizuar për këtë qëllim janë shpenzuar 663 milionë denarë, përkatësisht 32% nga parashikimi i përgjithshëm.

Në periudhën janar - qershor të vitit 2024, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve realizoi mjete në vlerë prej 2.093 milionë denarëve, që paraqet vetëm 10.3% nga buxheti i përgjithshëm për vitin 2024. Ato janë më të ulëta për 82.7% krahasuar me vitin paraprak. Zëri buxhetor më i theksuar i shpenzimeve të përgjithshme të këtij shfrytëzuesi buxhetor janë subvencionet dhe transfertat, realizimi i të cilave në gjysmën e parë të vitit 2024 ishte 326 milionë denarë (44.1% nga shpenzimet e përgjithshme), që ishte 49.9% e buxhetit vjetor për këtë qëllim. Për shpenzime kapitale janë shpenzuar 320 milionë denarë, që është 2.1% nga sa ishte planifikuar për tërë vitin, ndërsa të shpenzimet e përgjithshme kanë pjesëmarrje me 43.3%.

3.2 Menaxhimi i borxhit publik

Borxhi shtetëror në fund të tremujorit të parë për vitin 2024 shënon 7.543.9 milionë euro, respektivisht 51.5% e PBB-së së projektuar për vitin 2024, ndërsa borxhi publik⁶ shënon 8.769.9 milionë euro, respektivisht 59.8% e PBB-së (Grafiku 14). Njëkohësisht, në krahasim me fundin e vitit 2023, pjesëmarrja e borxhit shtetëror në PBB është më e ulët për 1.6 p.p., ndërsa e borxhit publik për 2.3 p.p.. Të dhënat për nivelin e borxhit implikojnë ristabilizimin e tij, i cili vjen pas periudhës së rritjes së borxhit si pasojë e krizës së shkaktuar nga pandemia e Covid-19.

Grafiku 14. Gjendja e borxhit shtetëror dhe publik (në % të PBB-së)




Burimi: Ministria e Financave

Nga aspekti strukturës së interesit të borxhit shtetëror, në fund të tremujorit të parë të vitit 2024, raporti i normës së interesit fiks dhe atij variabil shënon përkatësisht 73.5:26.5 (Grafiku 15). Nga aspekti i kompozimit

⁶ Me ndryshimet në Ligjin e Borxhit Publik në muajin maj të vitit 2019 (“Gazeta Zyrtare” nr. 98/2019), borxhi i paguarantuar është përfshirë në përkufizimin e borxhit publik.

valutor, borxhi në valutën vendase ka pjesëmarrje me 31.4% në portofolin e përgjithshëm të borxhit shtetëror, ndërsa borxhi i denominuar në valutën e huaj ka pjesëmarrje me 68.6%. Njëkohësisht, pjesëmarrja e borxhit në euro në borxhin e përgjithshëm shtetëror shënon 61.9% (duke përfshirë letrat shtetërore me vlerë vendase me klauzolë valutore), sa i përket të drejtave speciale të tërheqjes 6.5%, të borxhit në jenin japonez 0.2% dhe të borxhit të shprehur në dollarë amerikanë 0.04%.

Grafiku 15. Struktura e interesit (majtas) dhe struktura valutore (djathtas) e borxhit shtetëror në tremujorin e parë 2024.



Në periudhën janar - qershor të vitit 2024, Ministria e Financave ka emetuar letra shtetërore me vlerë në baza të rregullta në tregun e brendshëm, në përputhje me kalendarin për emetimin e letrave shtetërore me vlerë (LSHV).

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, janë kryer rishikime të rregullta të rejtingut kreditor të vendit nga agjencitë e rejtingut kreditor "Fitch" dhe "Standard & Poors".

- Në muajin janar 2024, Agjencia e Rejtingut Kreditor "Standard & Poors" e konfirmoi rejtingun kreditor të vendit në "BB-" me perspektivë stabile. Pritshmëritë e kësaj agjencie janë që hartimi proaktiv i politikave të Qeverisë së Maqedonisë dhe nivelet e moderuara të borxhit shtetëror do t'i neutralizojnë risqet e shumta që rezultojnë nga konflikti në Ukrainë. "Standard & Poors" theksoi se ata presin që konsolidimi fiskal të vazhdojë. Kriza do të ketë ndikim edhe në vitin 2024, por gjithsesi pritet që deficitin buxhetor të jetë më i ulët se në vitin 2023, respektivisht të arrijë në nivelin 3.4% (nga 4.6%).
- Në muajin prill 2024, Agjencia e Rejtingut Kreditor "Fitch" e konfirmoi rejtingun kreditor të vendit në "BB+" me perspektivë stabile. Pritshmëritë e kësaj agjencie janë që rritja e ekonomisë të përforcohet në 2.9%, e nxitur kryesisht nga konsumi privat, e mbështetur nga rritja e pagave, më pas nga realizimi i projektit të autostradave në korridoret 8 dhe 10d, si dhe nga fluksi i vazhdueshëm i investimeve të huaja direkte. "Fitch"-i parashikon se rritja do të rritet më tej në vitin 2025 në 3.6%, bazuar në perspektivat e përmirësuar të partnerët kryesorë tregtarë të vendit. Ndikim pozitiv pritet edhe nga përkrahja financiare nëpërmjet Planit të ri evropian të rritjes për Ballkanin Perëndimor.